



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 20, datë 31.01.2019

PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 17, DATË 29.01.2019, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR “PËR NUMRIN E KANDIDATËVE QË DO TË PRANOHEN NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 85, pika 1 dhe 262 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 29, pika 1 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 53, pika 2, 4 dhe 9, në nenin 55, pika 1, si dhe në nenin 56, pika 3 e ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 17, datë 29.01.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për numrin e kandidatëve që do të pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020”, bëhen shtesat e mëposhtme:

1.1 Në pikën 6, në nënndarjen “Kriteret e përgjithshme”, pas germës “h”, të shtohet germa “i” me këtë përmbajtje:

i) nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit;

1.2 Në pikën 8 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë që plotësojnë kriteret, i nënshtrohen konkursit të pranimit, duke paguar tarifën e regjistrimit për pjesëmarrjen në konkurs sipas Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës”.

2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR